Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Fatmir Thaqi	**09.12.2024**	**17.12.2024**	**2024/1184**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 06.12.2024, Operatori Ekonomik ILIR NOSHI B. I. Gjakovë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/1184, kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 21.11.2024 dhe kundër Njoftimit për nënshkrim të kontratës të datës 29.11.2024, ku Kompania Rajonale e Ujësjellësit Gjakova SH.A.ka në Gjakovë, ka lidhur kontratë me kontraktuesin AM BUR SH.P.K. Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit:

Titulli: "Mirembajtja servisimi i automjeteve per KRU 'Gjakova' sha", me nr. të prokurimit: KRURGJA-24-11429-2-2-5,

i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kompania Rajonale e Ujësjellësit GJAKOVA SH.A..

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 50,000.00 €.

Në pajtueshmëri me nenin 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-092, sipas ILIR NOSHI B. I.,janë si në vijim:

Autoriteti Kontraktues, KRU GJAKOVA ka vepruar në kundërshtim me Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, në mënyrë specifike me:

Neni 1 Qëllimi

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 34 Procedurat konkurruese me negociata

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

AK pavarësisht obligimit nga neni 1 i Ligjit te LPP-se qe të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoritet eve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Një obligim te tille nuk e ka përmbushur duke ber shkelej edhe këtij neni per faktin se AK, ne këtë raste duke mos na ftuar neve si OE ne këtë procedure per te dërguar oferton tone, dhe duke marr ne konsideratë se ne si OE kemi pasur kontratë e me hershme me AK KRU Gjakova' per Mirëmbajtjen dhe servisimin e automjeteve te njëjta qe janë edhe subjekt këtë procedure te negociuare. Është në shkelje flagrante të këtij neni dhe paragrafi ngase të gjithë procedurën e i ka zhvilluar pa publikim të njoftimit për kontratë, dhe ka vepruar në mënyre diskriminuese në përzgjedhjen e OE me te cilin ka zhvilluar procedurën për negocim duke diskriminuar kështu OE i cili ka pasur kontratën në se paku 6 vitet e shkuara. Pra ne si OE kemi pasë kontratë dhe kemi qenë duke kryer shërbimet e njëjta për të cilat është zhvilluar ky aktivitet i prokurimit. Ashtu sikurse neve kemi pasur ne stoke pjese te shumta rezerve per këto automjete te cilat nuk janë shfrytëzuar ne kontrata e me hershme dhe sigurisht qe ne oferton tone eventuale do te kishin çmimi me te ulet se OE. Ne kontratën e kaluar te nënshkruar me AK KRU Gjakova përmes procedure se negociuar pa publik te njoftimit per kontratë ne kishim një çmimi te ofertës me peshim prej 26,846.00 ndërsa ne këtë procedure kana rekomanduar OE me çmim prej 29,921.00 çmimi dukshëm me i larte se sa oferta e jon te kontratën paraprake. Ne kemi analizuar kontratën e nënshkruar te cilën e ka publikuar AK dhe nga aty kemi kuptuar se pothuajse ne 90% te çmimeve per njësi është çmimi me i shtrenjte se çmimi i kontratës tone paraprake. Kjo dëshmon se AK nuk ka luajtur një rol aktiv lidhur me çmimin duke kontraktuar një çmim më të lartë se çmimi përkatës i tregut, paraprak, gjë e cila ka ardhur si pasojë e aplikimit të kundërligjshëm të procedurës një burimore.

Nga zhvillimi i kësaj procedure AK me veprimet e tija vepruar ne kundërshtim **Neni 7 te LPP- Paragrafi 1**. citojmë: Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Vendimi i AK-se, per te mos na dërguar

edhe neve si OE ftesën per ofertim ne ketë procedurë, duke e marr parasysh faktin se kemi pasur kontratën e njëjte me AK-se, per me shume se 6 vite e per te cilat gjithmonë kemi pasur vlerësim te mira madje si prove ju bashkëngjisim Vlerësimin e AK-se per shërbimet tona nuk mund te kuptohet ndryshe vetëm si veprim i trajtimit te pa barbarët dhe diskriminues ndaj neve. Arsyetimi i AK-se nga vendimi per refuzim te kërkese per rishqyrtim se arsyeja se pse janë ftuar 3 OE tjera per negociata ka qen qe ti epet mundësi edhe OE tjerë te bashkëpunon me AK-se. AK gjate zhvillimit te kësaj procedure pikërisht ke vepruar ne kundërshtimin per përgjigjen e tije, sepse po te kishte ketë qellim do te ftonte edhe neve edhe OE tjera ne negociata dhe jo me mënyrë selektive te përzgjedhtë ne Operatoret, ne ketë formë duke diktuar fituesin. AK ka pasur mundësin dhe është dashur te na ftoj edhe neve ne ofertim.

Paragrafi 2. citojmë: Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik. AK gjatë zhvillimit të kësaj procedure ka vepruar në kundërshtim me paragrafin e këtij neni ngase ka zhvilluar një aktivitet të prokurimit me të vetmin qëllim për të diskriminuar OE të caktuar (në këtë rast neve si OE) dhe për të favorizuar OE tjerë të caktuar në kryerjen e këtyre shërbimeve. Nuk e kemi te qarte nga AK se cila është arsye e mos dërgimit te ftese per ofertim ne ketë procedure. Cila ka qen metologjia e përzgjedhjes se operatoreve e cilët janë dërguar ftesat per ofertim sepse nga aktiviteti e me hershme te zhvilluar nga AK per shërbimin e njëjte, OE i rekomanduar per kontrate nuk ka qen ofertues i me hershem, andaj detyrimisht lind dyshime per mënyre e përzgjedhjes se këtij OE. Nga Njoftimi mbi Vendim i AK-se, kuptohet se vetëm OE i rekomanduar per kontrate ka qen ofertues ne ketë procedure nga ku mund te nënkuptohet se porcesi i përzgjedhjes se OE pjesëmarrës është proces formal.

Shkelja e Neni 35 te LPP-se. AK ka shkelur dispozitat e këtij neni i cili paracaktuar se Autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës nder te tjera nëse, për aq sa është shumë e nevojshme për arsye të emergjencave ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarje objektivisht të verifikueshme të cilat nuk kanë pasur mundësi të parashikohen me arsye nga autoriteti përkatës kontraktues, autoriteti i tillë kontraktues nuk mund ta japë kohën e kërkuar për ushtrimin e cilësdo procedurë tjetër që parashtrohet në këtë ligj. Me kusht që kjo dispozitë të mos mund të shfrytëzohet nëse rrethanat që e kanë krijuar situatën emergjente ekstreme mund t'u atribuohen veprimeve neglizhente ose të qëllimta ose lëshimeve të autoritetit kontraktues. Ne si OE me te njëjtin AK kemi pasur kontratën e njëjte te nënshkruar Mirëmbajtja servisimi i automjeteve për tërë kompaninë e KRU Gjakova sh.a.- Ritender me numër identifikues: KRURGJA-24-1982-2-2-5 dhe numër KRURGJA-24-1982-2-2-5/C194 e cila ka përfunduar me date: 26.08.2024 dhe nga data e përfundimit te kontratës e deri me date: 04.11.2024 per me shume se 3 muaj nuk ka marr asnjë veprim procedural ne zhvillimin e procedurës per nënshkrim e ndonjë kontrate te re. Çuditërisht AK me date 21.11.2024 vendos te konttrbandoj ketë procedure te tenderimit dhe me nxitim nënshkruan kontratën e Re me një OE me çmim me te shtrenjte se kontrata paraprakë. Aq shpejt sa nuk respekton edhe afate kohore te ankesave. Në rastin konkret, gjetjet tregojnë se nuk ekziston asnjë nga situatat objektive dhe të detyrueshme që përcaktohen me paragrafin 1 dhe 2 të kësaj dispozite për aplikimin e procedurës së negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës. Situatat e shkaktuara nga ana e autoriteteve kontraktuese të çfarëdo natyre përfshirë, urgjencat etj të cilat vijnë nga planifikimi jo i duhur siç kërkohet me nenin 8 dhe 9 të LPP-së apo çfarëdo konsiderate tjetër, nuk janë arsye objektive të verifikueshme, të domosdoshme dhe as nuk mund të karakterizohen si raste të emergjencave ekstreme siç përcaktohet me nenin 48.3 të rregullorës Nr. 001/2022 për të justifikuar përdorimin e procedurave të mbyllura si në rastin konkret duke ju përshtatur një OE të

caktuar të cilit i janë dhënë avantazhe të padrejta në relacion me operatorët tjerë ekonomik që shkelin parimin e barazisë/mosdiskriminimit dhe eliminojnë konkurencën.

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale: 1.Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkese, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuara në këtë nen. Se ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me preferenca te caktuar ndaj OE te rekomanduar per kontrate, mund te vërtetohet nga fakti se AK tek kriteri i Kapacitetit teknik dhe profesional si jo me herët, nuk ka vendosur kriter qe OE te ketë te kryera shërbime te natyrës se njëjtë, kjo mund te dëshmohet nga Kriteret e përcaktuar nga AK në Dosje te tenderit. Provë: DT dhe Njoftimi per kontratë: Mirëmbajtja servisimi i automjeteve për tërë kompaninë e KRU Gjakova sh.a te datës:31.10.2023

AK me date: 21.11.2024 ka publikuar Njoftimin mbi vendim dhe Njoftimi per dhëne te kontratës (brenda ditës) duke mos i ofruar mundësin OE tjerë pjesëmarrës në këtë procedurë për parashtrimin e kërkesave per rishqyrtim siç percaktohet në **nenin 108/A** te LPP-së. Pavarësisht kësaj ndaj Njoftimi mbi vendim me date 26.11.2024 kemi parashtruar kërkesë per ri shqyrtim. AK me date: 27.11.2024 ka nxjerr vendim per refuzim te kërkesës per ri shqyrtim. AK pa respektuar afate ligjore sipas LPP-se, ka publikuar njoftimin per nënshkrim te kontratës me date: 29.11.2024. Nga ky veprim AK shkelur nenin 108/A te LPP-së dhe **Neni 61 paragrafi 61.1**, nen paragrafi a) Kurdo qe pezullimi i përmendur ndërlidhet me vendimin e AK për dhënie të kontratës, pezullimi i tillë nuk do të përfundojë para skadimit të një periudhe prej të paktën 10 ditë kalendarike nga data e publikimit të vendimit të AK. Ky veprim nga AK paraqet shkelej te rende te parimeve te LPP-se. AK ne ketë procedure ka pritur per me shume tre (3) muaj nga përfundimi i kontratës se rregullt duke mos iniciuar procedurën e re me kohe, dhe nuk ka pritur te kaloj afati 10 ditore per kalimin e afatit e ankesave. , Po ashtu, AK ka bërë shkelje duke mos e pritur afatin prej 05 ditëve pas publikimit te B58 Njoftim mbi vendimin per dhanje te kontratës , njoftimi sipas udhëzimeve të KRPP-se , siç përcaktohet edhe ne nenin 108/A te LPP-se , duke anashkaluar afatet dhe mos mundesin OE pjesmarres qe vet i ka ftuar në këtë procedurë të paraqesin kërkesën per rishqyrtim, duke mos i ofruar mundësin e parashtrimit te ankesës e cila është e garantuar me ligj.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, i propozojmë panelit shqyrtues te nxjerr:

VENDIM

1. Që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar.

2. Të anulohet B58 Njoftimi për Vendimin e AK-së , të datës: 21.11.2024

3. Te anulohet Kontrata e nënshkruar përmes kësaj procedure kundërligjorë.

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, <u>janë të njëjta</u> me ato të parashtruara në Kërkesën për Rishqyrtim.

KRITERET PËR VLERËSIM

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Lënda:	**Procesverbali i negocimit lidhur me aktivitetin e prokurimit:** Mirembajtja servisimi i automjeteve per KRU 'Gjakova' sha
Nr I prokurimit:	KRURGJA-24-11429-2-2-5
Datë	19.11.2024

Me datë 08.11.2024, është bërë hapja e ofertës se dorëzuar nga OE **AM BUR SH.P.K.**, me çmim ofertues prej 30.015.00€.

Komisioni i vlerësimit ka shikuar ofertën me te gjithë dokumentacionin e dorëzuar ne oferte. Është dërguar ftesa për negocim, ku negociatat do te zhvillohen me 19.11.2024, ne ora 13:00 dhe OE i është dërguar lista e çmimeve qe Operatori Ekonomik ofertues te beje dorëzimin e ofertës të re financiare deri me date 19.11.2024 para orës 12:00.

Oferta e re financiare është dorëzuar brenda afateve kohor, me date 18.11.2024 duke ofruar ofertën financiare ne total prej 29.956,00€

Gjate diskutimit ne lidhje me çmimin, komisioni i vleresimit arriti qe te negocioje ne çmim duke arritur çmimin perfundimtar ne vlere prej 29.921,00€.

Andaj vlera perfundimtare e cmimit me TVSH eshte 29.921.00€

Përfaqësuesi nga OE,

Sylejman Burjani - Drejtor

Komisioni i vlerësimit :

1. Doruntina Basha Jusufi- Inxhiniere — Kryetare
2. Jetmir Jaha- Pergjegjes per GIS — Anëtarë

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Ilir Noshi**

Operatori Ekonomik Ankues**,** ILIR NOSHI B. I.**,** ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me datë 25.11.2024, përderisa AK me datë 27.11.2024 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

Operatori Ekonomik Ankues, deklaron se Nuk pajtohet me B58 Njoftimin mbi vendimin e AK dhe B08 Njoftim për dhënie të kontratës të publikuara nga AK- Kompania Rajonale e Ujësjellësit Gjakova SH.A.të datë 21.11.2024 dhe PRETENDON se AK ka bërë shkelje të nenit 1 dhe 7 të LPP-së gjatë procedurës së tenderimit për këtë aktivitet të prokurimit.

Dispozitat e shkelura të LPP-së, sipas Operatori Ekonomik ankues, nga ana e Autoriteti Kontraktues, janë: *Neni 1 i LPP-së, Neni 7 i LPP-së, Neni 35 i LPP-së dhe Neni 59 i LPP-së.*

Eksperti shqyrtues, sipas autorizimit 2024/1184, pas ekzaminimit të tenderit dhe rrjedhës së procedurës së vlerësimit dhe pretendimeve të palës ankuese në ankesë, duke u bazuar ne shkresat e lendes se trajtuar **ka konstatuar dhe sqaron me sa vijon.**

Sqarimi hyrës

Autoriteti Kontraktues – KRU Gjakova, gjatë këtij aktiviteti ka aplikuar *procedure të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë*, vlerë e mesme, lloji i kontratës shërbim, vlera e parashikuar është: 50,000.00 €. AK me dt. 04.11.2024 ju ka dërguar ftesë 3 OE (1. AM BUR sh.p.k, 2. Te Beka sh.p.k. dhe 3. Top Group sh.pk.). Operatori ekonomik ankues ILIR NOSHI B. I. Gjakovë, nuk është ftuar edhe pse ka pasur kontratën e njëjte te nënshkruar Mirëmbajtja servisimi i automjeteve për tërë kompaninë e KRU Gjakova sh.a. cila ka përfunduar me date: 26.08.2024.

Hapja e ofertave është bërë me 08.11.2024, ku vetëm OE AM BUR ka dorëzuar tender. Vlerësimi i tenderëve dhe Njoftimi mbi vendimin e AK është publikuar me 21.11.2024, ku është rekomanduar për kontratë tenderuesi AM BUR.SH.p.k Gjakovë.

Për shkak të mos dërgimit të ftesës për pjesëmarrje Operatori ekonomik ankues ILIR NOSHI B. I. ka dorëzuar, kërkesë për ri-shqyrtim, kundër Njoftimi mbi vendimin e AK dhe nënshkrimit të kontratës. AK, ka nxjerr vendime mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim si e pabazuar, me ç 'rast OE ankues brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në OSHP me pretendime ankimore të cilat janë shqyrtuar nga eksperti në vijim.

1. **Pretendimi i Operatori Ekonomikankues, se AK, ka shkelur nenin 1 i LPP-së** (*Ekonomiciteti dhe Efikasiteti*) dhe **nenin 7 i LPP-së** (*Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi*), për faktin se AK, ne ketë raste duke mos na ftuar neve si OE ne ketë procedure për te dërguar ofertën tone, dhe duke marr ne konsideratë se ne si OE kemi pasur kontratë e me hershme me AK KRU Gjakova' për

Mirëmbajtjen dhe servisimin e automjeteve te njëjta qe janë edhe subjekt ketë procedure te negociuar.

Vendimi i AK-se, për te mos na dërguar edhe neve si OE ftesën për ofertim ne ketë procedurë, duke e marr parasysh faktin se kemi pasur kontratën e njëjte me AK-se, për me shume se 6 vite e për te cilat gjithmonë kemi pasur vlerësim te mira madje si prove ju bashkëngjisim Vlerësimin e AK-se për shërbimet tona nuk mund te kuptohet ndryshe vetëm si veprim i trajtimit te pa barbarët dhe diskriminues ndaj neve.

1. Përgjigje në pretendimet e lartë cekura (neni 1 i LPP-së dhe **neni 7 i LPP-së**)

Pretendimi i Operatori Ekonomik ankues, se AK, ka shkelur nenin 1 i LPP-së (*Ekonomiciteti dhe Efikasiteti*) është i bazuar, sepse gjatë zhvillimit të procedurës pa të drejtë nuk e ka ftuar për pjesëmarrje në këtë procedurë të negociuar Operatorin Ekonomik ankues ILIR NOSHI B. I..

Sipas rrethanave të zhvilluar lidhur me këtë procedurë, në bazë të shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit për këtë aktivitet të prokurimit, pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues se AK, nuk ju ka përmbajtur *nenit 1 të LPP-së*, janë të qëndrueshme, sepse më këtë veprim nuk ka luajtur rol aktiv për shpenzimin e parasë publike, që të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike.

Çdo AK, duhet të siguroj integritet dhe përgjegjësi gjatë zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.

AK, gjatë zhvillimit të kësaj procedure ka bërë shkelje të *nenit 7 të LPP- së*, nuk i ka trajtuar të gjithë operatorët e interesuar ekonomik, konkretisht OE ankues në mënyrë të barabartë, me aktet dhe veprimet e saj nuk e ka respektuar nenin 7 të LPP-së, në paragrafin 2, ku thuhet: "*Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik"* si dhe paragrafin 6, ku thuhet: *Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit ….(iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik…"*, andaj në këtë rast kemi të bëjë me diskriminimin e Operatori Ekonomik ankues dhe pretendimi i tij është i bazuar.

2. Pretendimi i Operatori Ekonomikankues, se AK, ka shkelur nenin 35 i LPP-së (*Procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës*)

AK ka shkelur dispozitat e këtij neni i cili paracaktuar se Autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës nder te tjera nëse, për aq sa është shumë e nevojshme për arsye të emergjencave ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarje objektivisht të verifikueshme të cilat nuk kanë pasur mundësi të parashikohen me arsye nga autoriteti përkatës kontraktues, autoriteti i tillë kontraktues nuk mund ta japë kohën e kërkuar për ushtrimin e cilësdo procedurë tjetër që parashtrohet në këtë ligj. Me kusht që kjo dispozitë të mos mund të shfrytëzohet

nëse rrethanat që e kanë krijuar situatën emergjente ekstreme mund t'u atribuohen veprimeve neglizhente ose të qëllimta ose lëshimeve të autoritetit kontraktues.

Përgjigje në pretendimet e lartë cekura (neni 35 i LPP-së)

Eksperti Shqyrtues sqaron se, bazuar në analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara në platformën elektronike E-prokurimi, AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 35 të LPP-së, duke e zhvilluar aktivitetin e prokurimit përmes procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, sepse me mos dërgimit të ftesës operatorit ekonomik ankues i cili pse ka pasur kontratën e njëjte te nënshkruar Mirëmbajtja servisimi i automjeteve për tërë kompaninë e KRU Gjakova sh.a.-Ritender me numër: KRURGJA-24-1982-2-2-5/C194 e cila ka përfunduar me date: 26.08.2024.

IV.3) Emri dhe adresa e operatorit ekonomik, me të cilin është nënshkruar kontrata

Kontrata No.: **KRURGJA-24-1982-2-2-5/C194**
Grupi No.: **1**
Grupi: **Mirëmbajtja servisimi i automjeteve për tërë kompaninë e KRU Gjakova sh.a.-Ritender**
Data e nënshkrimit te kontratës: 26.03.2024
Numri i tenderëve te pranuar: 1
Numri i tenderëve te përgjegjshëm: 1

Emri zyrtar: **Ilir Noshi**		
Adresa Postare: **yjet e erenikut**		
Qyteti: **gjakove**	Kodi postar: **50000**	Vendi: **Kosovë**
URL (nëse aplikohet):		
Personi kontaktues:	Email:	
Telefoni: **044133611**	Faksi:	

IV.4) Informacione mbi vlerën e kontratës

Vlera e përgjithshme e kontratës **26,295.00** EUR

Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët: **26,295.00**
Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të lartë: **26,295.00**

Eksperti shqyrtues vlerëson se qëndrojnë të bazuara pretendimet e lartcekura të OE ankues, për faktin se AK me veprimet e saj rezulton se procedura me negociata pa publikim të njoftimit me kontratë, duke e kufizuar konkurrencën dhe diskriminuar OE ankues është aplikuar dhe udhëhequr në kundërshtim me nenin 35 të LPP-së. Për faktin se neni 35 i LPP-së përcakton në mënyrë të qartë situatat dhe rastet kur AK mund të përdorin një procedurë me

negociata pa publikim të njoftimit për kontratë. Në rastin konkret, gjetjet tregojnë se nuk ekziston asnjë nga situatat objektive dhe të detyrueshme që përcaktohen me paragrafin 1 dhe 2 të kësaj dispozite për aplikimin e procedurës së negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës. Nga shënimet dhe dokumentacioni i shqyrtuar, qëndron pretendimi i OE ankues se deri te kjo situatë ka ardhur për shkak të veprimeve neglizhente ose të qëllimta ose lëshimeve të autoritetit kontraktues, pasi që nga përfundimi i kontratës për të njëjtin shërbim e cila ka përfunduar me date: 26.08.2024 deri me 21.11.2024 ka kaluar më tepër se 3 muaj. Situatat e shkaktuara nga ana e autoriteteve kontraktuese të çfarëdo natyre përfshirë, urgjencat etj. të cilat vijnë nga planifikimi jo i duhur siç kërkohet me nenin 8 dhe 9 të LPP-së apo çfarëdo konsiderate tjetër, nuk janë arsye objektive të verifikueshme, të domosdoshme dhe as nuk mund të karakterizohen si raste të emergjencave ekstreme siç përcaktohet me nenin 48.3 të rregullores Nr. 001/2022 për të justifikuar përdorimin e procedurave të mbyllura si në rastin konkret duke ju përshtatur një OE të caktuar të cilit i janë dhënë avantazhe të padrejta në relacion me operatorët tjerë ekonomik që shkelin parimin e barazisë/mos diskriminimit dhe eliminojnë konkurrencën. Në rastin konkret me çmimin e kontraktuar në krahasim me çmimin për njësi dhe kontratën paraprake për të njëjtin shërbim, dëshmon se AK nuk ka luajtur një rol aktiv lidhur me çmimin duke kontraktuar një çmim më të lartë se çmimi përkatës i tregut, paraprak, gjë e cila ka ardhur si pasojë e aplikimit të kundërligjshëm të procedurës së *negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë*.

Eksperti shqyrtues vlerëson se AK, ka bere shkelje të dispozitave të LPP-së, ka shkel parimin e barazisë/mos diskriminimit dhe eliminimin e konkurrencës, ku në këtë procedurë ka ftuar gjithsej 3 (tre) OE tjerë duke ju dhënë avantazhe të padrejta, kurse e ka përjashtuar Operatorin Ekonomik ankues i cili ka pasur kontratën e njëjte të nënshkruar me kompaninë e KRU Gjakova, dhe nga vlerësimi i kontratës së kaluar shihet se OE i ka kryer shërbimet e servisimit të automjeteve me sukses dhe performancë 100 %.

Lista e vleresimeve së performancës të Operatorit Ekonomik - Contractor performance evaluation

Numri i Kontrates	Emërtimi i kontratës	Autoriteti kontraktues	Tipi i kontrates	Pala kontraktuese	Grupi i OE	FPP	Vlera €	Data e fillimit	Data e Përfundimit	Treguesi i performancës	Ditët
KRURGJA-21-1529-2-1-1/ C73	Mirëmbajtja Servisimi i automjeteve për terë kompaninë e KRU Gjakova sh.a.	Kompania Rajonale e Ujësjellësit GJAKOVA SH.A.	Kontratë kornizë	Ilir Noshi		93000000-8	209.307,60	15.06.2021	14.06.2024	100.00%	324
KRURGJA-21-1529-2-1-1/ C73	Mirëmbajtja Servisimi i automjeteve për terë kompaninë e KRU Gjakova sh.a.	Kompania Rajonale e Ujësjellësit GJAKOVA SH.A.	Kontratë kornizë	Ilir Noshi		93000000-8	209.307,60	15.06.2021	14.06.2024	100.00%	324
KRURGJA-21-1529-2-1-1/ C73	Mirëmbajtja Servisimi i automjeteve për terë kompaninë e KRU Gjakova sh.a.	Kompania Rajonale e Ujësjellësit GJAKOVA SH.A.	Kontratë kornizë	Ilir Noshi		93000000-8	209.307,60	15.06.2021	14.06.2024	100.00%	323
KRURGJA-24-1982-2-2-5/ C194	Mirëmbajtja servisimi i automjeteve për terë kompaninë e KRU Gjakova sh.a - Riteender	Kompania Rajonale e Ujësjellësit GJAKOVA SH.A.	Kontratë kornizë	Ilir Noshi		93000000-8	26.295,00	26.03.2024	26.08.2024	100.00%	56

Ofertë ka dorëzuar vetëm një OE, AM BUR sh.p.k të cilin AK e ka shpallur fitues, me datë 21.11.2024 e ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e AK, kurse 2 Operatorë tjerë ekonomik i ka ftuar vetëm për të treguar se ka ftuar ma tepër se një OE, të cilët nuk kanë dorëzuar tender.

Pas vlerësimit-negocimit, AK e ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e AK dhe B08 Njoftim për dhënie të kontratës me datën 21.11.2024, duke mos i ofruar mundësin OE tjerë të interesuar për këtë procedurë për parashtrimin e kërkesave për rishqyrtim siç përcaktohet në nenin 108/A te LPP-së.

Edhe interpretimi i ofruar nga KRPP-se e qartëson mundësin e parashtrimit te kërkesës për rishqyrtim citat '' Paragrafi 1 i nenit 108/A të LPP-së, përcakton: "1. Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit". Në kuptim të paragrafit 1 të nenit 108/A të LPP-së, pavarësisht procedura që është përdorur, çdo "palë e interesuar" siç përkufizohet në nenin 4, nën paragrafin 1.26 të LPP-së, e cila mendon se të drejtat e tij/saj janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti prokurimi dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqes një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Si rrjedhojë, edhe në rastin e Procedurave të negociuara pa Publikimin e Njoftimit për Kontratë, një OE mund të parashtrojë një Kërkesë për Ri-shqyrtim të vendimit të AK-së, nëse të njëjtin AK ka mund të ftojë që të dorëzojë ofertë, por që nuk e ka ftuar. Pra e drejta në kërkesë për rishqyrtim/ankesë e çdo pale të interesuar është e garantuar me ligj. Megjithatë, në rastin e Procedurave të Negociuara pa Publikimin e Njoftimit për kontratë siç përcaktohen rastet e emergjencave ekstreme me nenin 35.2.1 (iii) të LPP, AK mund të nënshkruaj kontratën pa kaluar periudhat kohore të ankesave, sepse ky kusht përjashtohet me nenin 26, paragrafin 4, nën paragrafin 4.1 të LPP-së. Si rrjedhojë, efekti i pezullimit nuk vlen vetëm në rastet e emergjencave ekstreme siç përcaktohen me nenin 35.2.1 (iii) të LPP-së, si në vijim, citat "(iii) nëse, për aq sa është shumë e nevojshme për arsye të emergjencave ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarje objektivisht të verifikueshme të cilat nuk kanë pasur mundësi të parashikohen me arsye nga autoriteti përkatës kontraktues, autoriteti i tillë kontraktues nuk mund ta japë kohën e kërkuar për ushtrimin e cilësdo procedurë tjetër që parashtrohet në këtë ligj. Me kusht që kjo dispozitë të mos mund të shfrytëzohet nëse rrethanat që e kanë krijuar situatën emergjente ekstreme mund t'u atribuohen veprimeve neglizhente ose të qëllimta ose lëshimeve të autoritetit kontraktues". Në raste të tjera (jo emergjente ekstreme) të Procedurave të negociuara pa publikim e Njoftimit për Kontratë AK nuk mund të nënshkruaj kontratën pa kaluar periudhat kohore të ankesave''.

Eksperti shqyrtues mendon se, AK ka bërë shkelje duke mos e pritur afatin ligjor pas publikimit te B58 Njoftimin mbi vendimin e AK dhe B08 Njoftim për dhënie të kontratës me datën 21.11.2024, që është 5 ditë, për të cilat raste u cekë më lartë edhe në njoftimin dhe udhëzimin nga KRPP-ja dhe është e përcaktuar me nenin 108/A te LPP-se.

Shkelje tjetër sipas ekspertit shqyrtues është se, pas kërkesës për rishqyrtim nga OE ankues ILIR NOSHI B. I. Gjakovë me datë 25.11.2024, AK nuk e kishte pezulluar aktivitetin e prokurimit, kurse me dt. 27.11.2024 e kishte refuzuar kërkesën për ri-shqyrtim si të pa-bazuar dhe me dt. 29.11.2024 ka nënshkruar kontratën me OE–në AM BUR SH.P.K. Gjakovë edhe përkundër faktit se OE ankues me dt. 06.12.2024 kishte dorëzuar ankesën në OSHP. AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 35 dhe nenin 112 paragrafi 1 të LPP-së pasi që ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit edhe për kundër dorëzimit të ankesës, e cila eobligon autoritetin kontraktuesqëautomatikisht ta pezullojëzbatimineaktivitetittëprokurimitmetëcilinka tëbëjëankesa nëfjalë.

Pretendimi i Operatori Ekonomikankues, se AK, ka shkelur nenin 69 i LPP-së (*Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale*)

1.Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkese, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuara në këtë nen.

Përgjigje në pretendimet e lartë cekura (neni 69 i LPP-së)

Eksperti shqyrtues vlerëson se nuk qëndron i bazuar pretendimi i lartcekur i OE ankues, për faktin se AK pasi që ka planifikuar ta realizoj këtë aktivitet për shërbime me sukses, ka vendosur në DT te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, kërkesa minimale relevante për kapacitetin teknik dhe profesional andaj në këtë rast nuk kemi të bëjë me diskriminimin e Operatori Ekonomik ankues dhe pretendimi i tij është i pabazuar.

Për më tepër, eksperti shqyrtues vlerëson se aplikimi i kësaj procedure për veç që është në kundërshtim me nenin 35 të LPP-së, duke e zhvilluar aktivitetin e prokurimit përmes procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë edhe rezultati i saj nuk është në pajtim me nenin 48 paragrafin 4 të Rregullores për Prokurimin Publik Nr.001/2022, për faktin se vet çmimi i kontraktuar në krahasim me çmimin dhe kontratën paraprake, dëshmon se AK nuk ka luajtur një rol aktiv lidhur me çmimin duke kontraktuar një çmim më të lartë se çmimi përkatës i tregut, nuk ja ka arritur qëllimit të LPP-së dhe vlerën për para.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, ndërsa kontrata e nënshkruar nga AK të shfuqizohet.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Kompania Rajonale e Ujësjellësit GJAKOVA SH.A.**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Ilir Noshi**

Fatmir Thaqi